



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

The background of the cover is a high-angle, wide shot of a city, likely Tirana, Albania. It shows a dense urban landscape with numerous multi-story buildings, some with balconies. In the foreground, there is a large, open public square with many people walking. To the left of the square, there is a prominent white clock tower with a pointed roof. To the right, there is a large, modern building with a curved facade and many windows. The sky is clear and blue, and the overall lighting suggests a bright, sunny day. A large, semi-transparent blue shape, resembling a stylized letter 'A' or a large 'L', is overlaid on the right side of the image, partially covering the city scene.

RAPORT MBI AKTIVITETIN E KI 2023

Këshilli i Investimeve (KI) ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. KI kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që nxisin mirëfunksionimin e tregut.

KI kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe ka në përbërje përfaqësues të qeverisë, sektorit privat dhe partnerëve për zhvillim.

KI mbështetet nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).



PËRMBAJTJA

Hyrje	6
Mbi klimën e investimeve	10
Mbledhje plenare	12
Konsultime	20
Rekomandime të përmbushura gjatë vitit 2023	22
Forcimi i zbatimit të Reformave	24
Komunikim dhe Vizibilitet	25
Angazhimi i partnerëve	26
Avokim dhe Ndërgjegjësim	28
Anketat e KI gjatë 2023	30
Dokumente	31
Planet për të ardhmen	33
Numra të rëndësishëm	34
Anëtarë të KI 2023	35



“ Jam i nderuar që kam qenë i përfshirë në krijimin e Këshillit të Investimeve në 2015 dhe më vjen mirë të shoh që ndër vite është zhvilluar në një trup dhe në një platformë efektive diskutimi, shkëmbimi idesh dhe rekomandimesh. Mendoj që është një nga platformat më efektive trepalëshe, ku marrin pjesë: institucionet, si qeveria apo Banka e Shqipërisë; biznesi, ku ndër to edhe biznesi i diasporës; si dhe donatorët apo aktorët ndërkombëtare, ku një rol kyç luan BERZH. Besoj se është një forum shumë i mirë për të shkëmbyer qëndrime dhe ide, qoftë për sfidat me të cilat përballlet biznesi, qoftë për iniciativa të qeverisë të cilat ndikojnë klimën e biznesit dhe ekonominë.

Mr Ervin Mete
Ministër i Financave dhe Ekonomisë,
Kryetar i Këshillit të Investimeve (2023)
6 tetor 2023

OBJEKTIVAT E VEPRIMTARISË GJATË 2023

Në përputhje me objektivin kryesor të Këshillit të Investimeve (KI) për forcimin e besimit midis aktorëve kryesorë dhe institucionalizimin e dialogut politik mbi klimën e investimeve në vend, puna e Sekretariatit u bazua në shtyllat e mëposhtme:

PËRAFRIMI I AGJENDËS SË KI ME SHQETËSIMET E BIZNESIT VENDAS DHE ANALIZIMI I ÇËSHTJEVE TË KLIMËS SË INVESTIMEVE
Arritur përmes kryerjes së vrojtimeve tematike, konsultimeve të fokusuara, hulumtimit të raporteve kombëtare dhe ndërkombëtare, ofrimit të përditësimeve gjashtë-mujore mbi indikatorët makro-ekonomikë të vendit dhe organizimit të mbledhjeve në nivel ekspertësh.

KOORDINIMI I PËRFAQËSIMIT GJITHËPËRFSHIRJES SË SHOQATËS SË BIZNESIT NË KI
Zbatimi i një sistemi rotacioni për anëtarët përfaqësues të biznesit për të ofruar sa më shumë gjithëpërfshirje.

MUNDËSIMI I NJË DIALOGU TË STRUKTURUAR
Nëpërmjet përgatitjes së një agjende gjithëpërfshirëse dhe të harmonizuar temash për mbledhjet e Këshillit përmes një procesi të kujdesshëm votimi dhe konsultimi; organizimit të mbledhjeve plenare me përfaqësim gjithëpërfshirës dhe konstruktiv dhe shpërndarjes së dokumentet teknike të mirë-konsultuara dhe procesverbaleve të mbledhjeve brenda afateve kohore—të gjitha të vëna në dispozicion në mënyrë transparente për publikun në faqen e internetit të KI.

AVOKIMI PËR MASAT PRIORITARE TË POLITIKAVE
Publikim të përditësimeve *përkatëse* mbi klimën e investimeve në mediat sociale, kontribut i

Sekretariatit në aktivitete të *ndryshme të shoqatave të biznesit* mbi klimën e investimeve dhe bashkëpunim me universitete dhe platforma të tjera.

PËRAFRIMI ME PRIORITETET KOMBËTARE DHE MBËSHTETJE NË PROCESIN E PËRAFRIMIT ME BE-NË
Konsultim për reformat strukturore, duke kontribuar në procesin e shqyrtimit të BE-së dhe politikat kryesore ekonomike në mënyrë që puna e Këshillit të jetë në përputhje me agjendat kombëtare dhe proceset e përafrimit të vendit me BE-në.

MONITORIMI SISTEMATIK I PROGRESIT TË REKOMANDIMEVE TË KI
Ndjekje periodike me institucionet përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve, përditësim i bazës së të dhënave për matjen e rezultateve dhe publikim i raporteve mbi ecurinë vjetore.

HYRJE

Mirë se vini në Raportin Vjetor të Veprimtarisë së Këshillit të Investimeve (KI) për vitin 2023. Ky raport ofron një pasqyrë të plotë të iniciativave, arritjeve dhe përpjekjeve të vazhdueshme të KI për lehtësimin e komunikimit ndërmjet qeverisë dhe sektorit privat, duke përmirësuar mjedisin e biznesit dhe adresimit të sfidave kryesore me të cilat përballen bizneset në Shqipëri.

NGJARJET KRYESORE

- Gjatë vitit 2023, KI lehtësoi diskutimet e bazuara në konsultim përmes **katër takimeve plenare** dhe **katër tryezave të rrumbullakëta teknike**, rezultuar me angazhimin e 155 bizneseve dhe formulimin e **31 rekomandimeve të reja**.
- Që nga viti 2015, KI ka miratuar 326 rekomandime. Vetëm gjatë vitit 2023 janë marrë në konsideratë 44 rekomandime nga institucionet përkatëse për zbatimin e tyre. Tashmë, 24 rekomandime janë përmbushur me sukses, ndërsa 20 rekomandime të tjera janë drejt realizimit.
- Puna e Këshillit për gjithëpërfshirje ka rritur ndër vite interesin e shoqatave të biznesit për anëtarësim, çka solli në një ndryshim të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) 294/2015, “Për krijimin e Këshillit të Investimeve”. Ky ndryshim **dyfishoi numrin e anëtarëve jo të përhershëm** me mandat dy vjeçar të shoqatave të biznesit nga katër në tetë.

- Nëpërmjet një qasje inovative të nisur në vitin 2022, procesi i përcaktimit të agjendës së Këshillit është zgjeruar me pjesëmarrjen jo vetëm të anëtarëve të KI, por edhe të aktorëve të tjerë. Kjo qasje siguroi një kontribut gjithëpërfshirës përmes votimit në janar dhe tetor, duke identifikuar në mënyrë efektive prioritetet e biznesit dhe pritshmëritë e partnerëve, dhe duke ofruar një kuptim të plotë të sfidave dhe aspiratave kryesore.
- Gjatë nëntë muajve të parë të vitit, Këshilli u kryesua nga znj. Delina Ibrahimaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë. Më pas, drejtimi i Këshillit i kaloi z. Ervin Mete, i cili zëvendësoi znj. Ibrahimaj në rolin e ministrit dhe kryetarit të Këshillit të Investimeve.
- Sekretariati i Këshillit të Investimeve realizoi **dhjetë analiza teknike**, përfshirë anketa me të dhëna nga 905 kompani, duke ofruar njohuri të vlefshme për formulimin e rekomandimeve.
- Sekretariati dha gjithashtu një kontribut të rëndësishëm në ngjarje të nivelit të lartë kombëtar dhe ndërkombëtar, duke shërbyer si panelist në forume të ndryshme dhe duke përforcuar besueshmërinë e Këshillit të Investimeve.

Në përgjithësi, progresi i punës së KI nënvizon efektivitetin e tij në promovimin e politikëbërjes bazuar në konsultim, nxitjen e përfshirjes së aktorëve kryesorë dhe përmirësimin e mjedisit të biznesit në vend. Kjo riafirmmon rolin e rëndësishëm të KI në përpjekjet e qeverisë për të nxitur rritjen dhe zhvillimin ekonomik.



KALENDARI I AKTIVITETEVE KRYESORE gjatë 2023

Mbledhje fokus-grup me biznese mbi sfidat e biznesit gjatë kalimit në burime alternative të energjisë, bashkëorganizuar me Dhomën Ekonomike të Gruas (DHEG)

Publikim "Vlerësimi nga anëtarët dhe bashkëpunëtorët e Këshillit të Investimeve 2022"

Mbledhje XXIX e KI "Sfidat e NVM-ve gjatë kalimit në burime alternative të energjisë"

Kontribut në takimin bilateral Shqipëri-BE në Bruksel për shqyrtimin analitik të kapitullit të Parë të Grupit, "Themeloret"

Shkurt

Publikim i Notës Teknike "Sfidat e NVM-ve gjatë kalimit në burime alternative të energjisë"

Gjetjet e anketës "Pasiguritë e sipërmarrësve vendas mbi diversifikimin e energjisë"

Kontribut në Tryezën Rajonale të Rrjetit të Profesionistëve të Rinj (YPN) "Rritja e punësimit të denjë në Ballkanin Perëndimor"

Kontribut në Konferencën e DHEG "Forcimi i urave të bashkëpunimit ndërmjet grave afariste në rajon"

Publikim "Raporti i Monitorimit të Rekomandimeve 2022"

Mars

Kontribut në Forumin Ekonomik "Klima e biznesit, produktiviteti dhe kapitali njerëzor"

Mbledhje XXX e KI-së "Nga pagat e ulëta tek produktiviteti në punë"

Gjetjet e Anketës së Biznesit "Paga Minimale dhe Produktiviteti"

Publikim "Përmbledhje e Treguesve Makro-Ekonomikë të Shqipërisë 2022"

Prill

Publikim i Notës Teknike "Nga Pagat e Ulëta tek Produktiviteti në Punë"

Kontribut në mbledhjen e Grupit të Financuesve të Projektit WBIF

Maj

Mbledhje Fokus Grup me biznese mbi shërbimet publike dixhitale të ofruara për bizneset, bashkëorganizuar me Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB)

Qershor

Mbledhje fokus-grup me biznese mbi shërbimet publike digjitale të ofruara për biznesin, bashkëorganizuar me DHEG

Mbledhje fokus-grup me ekspertë mbi shërbimet publike digjitale të ofruara për biznesin

Gjetjet e anketës "Cilësia e shërbimeve publike digjitale sipas këndvështrimit të biznesit"

Pjesëmarrje në grupin e parë ndërinstitucional të punës për Përgatitjen e Udhërrëfyesit për Arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (organizuar nga SASPAC)

Korrik

Publikim "Përmbledhje e Treguesve Makro-Ekonomikë të Shqipërisë, Janar - Qershor 2023"

Memorandum Mirëkuptimi nënshkruar me Institutin e Statistikave (INSTAT)

Gusht

Kontribut në Samitin IV të Gruas së Diasporës Shqiptare "Me mendje dhe zemër në Shqipëri"

Shtator

Mbledhje XXXI e KI "Për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike të digjitalizuara ndaj biznesit"

Tetor

Publikim i notës teknike "Për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike të digjitalizuara për biznesin"

Nëntor

Mbledhje XXXII e KI "Konsultimi i Reformave Strukturore të Programit të Reformave Ekonomike (ERP) 2024-2026"

Komente zyrtare për draft ERP 2024-2026

Dhjetor

MBI KLIMËN E INVESTIMEVE

E KONOMIA SHQIPTARE: Në vitin 2023, rritja ekonomike e Shqipërisë arriti në 3.4%, sipas vlerësimeve të INSTAT. Kjo rritje është ndikuar nga zhvillimet e brendshme dhe pritshmëritë për ekonominë globale, veçanërisht brenda Bashkimit Evropian (BE). Për periudhën afatmesme 2024-2027, parashikimet zyrtare sugjerojnë një normë mesatare vjetore rritjeje prej rreth 4%. Sipas të dhënave të fundit të INSTAT, shkalla zyrtare e papunësisë për individët mbi 15 vjeç shënoi 10.7% në tremujorin e katërt të vitit 2023, një rënie prej 1.2% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në vitin 2023, investimet e huaja direkte arritën vlerën 1,492 milionë euro, duke reflektuar një rritje të dukshme prej 8.7% krahasuar me vitin 2022. Këto investime ishin kryesisht të fokusuara në asetet e prekshme, sektorin e hidrokarbureve, ndërmjetësimin financiar dhe sektorin e energjisë. Rritja mesatare vjetore e çmimeve në vitin 2023 u ul në 4.8%, nga 6.7% që ishte në vitin 2022. Që nga fundi i vitit 2011, normat mujore të inflacionit me bazë vjetore kanë mbetur vazhdimisht nën objektivin prej 3% të Bankës së Shqipërisë (BSH). Megjithatë, nga nëntori 2021, inflacioni filloi të rritet dhe kaloi objektivin e BSH-së, duke arritur kulmin në tetor 2022 në nivelin 8.3%. Edhe pse ka pasur prirje rënëse pas këtij piku, inflacioni ka mbetur mbi objektivin prej 3% të BSH-së.

ZHVILLIME POLITIKE: Në nëntor 2023, Shqipëria përfundoi rishikimin analitik të legjislationit të saj, i njohur si “procesi i shqyrtimit”, duke vlerësuar përputhshmërinë e saj me *acquis*. Përafërsisht 1,000 ekspertë nga sektorë të ndryshëm, përf-

shirë administratën publike, institucionet e pavarura, shoqërinë civile dhe komunitetin e biznesit, u angazhuan në këtë rishikim gjithëpërfshirës. Më herët gjatë vitit, Sekretariati i Këshillit të Investimeve avokoi për platformën e KI-së përpara Komisionit të BE-së në Bruksel, duke theksuar rëndësinë e konsultimit publik dhe përfshirjes së biznesit në procese të tilla. Në tetor, Tirana priti për

herë të parë jashtë zonës së BE-së si Samitin e Punëve të Jashtme, ashtu edhe Samitin e Procesit të Berlinit. Këto ngjarje të rëndësishme riafirmuan perspektivën evropiane të rajonit dhe diskutuan një Plan Rritjeje për të përshpejtuar integrimin ekonomik rajonal, duke hapur potencialisht rrugën që vendet e Ballkanit Perëndimor të integrohen gradualisht në tregun e vetëm të BE-së përpara anëtarësimit. Fundi i vitit 2023 gjithashtu shënoi përfundimin e mandatit dyvjeçar të Shqipërisë në Këshillin

e Sigurimit të OKB-së. Ndërkohë, kandidatura e Shqipërisë në Këshillin e të Drejtave të Njeriut dhe Bordin Ekzekutiv të UNESCO-s mori mbështetje të konsiderueshme përmes votave, duke theksuar njohjen dhe miratimin ndërkombëtar.

NDRYSHIME INSTITUCIONALE: Në shtator 2023, kryesimi i Këshillit të Investimeve pësoi ndryshime pas një riorganizimi të kabinetit qeveritar nga Kryeministri, ku z. Ervin Mete mori rolin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Z. Mete kryesoi dy mbledhje të KI-së dhe miratoi planin e punës dhe listën e temave për diskutim gjatë vitit 2024, të votuar nga anëtarët e KI. Njëkohësisht, znj. Laura Plaku u emërua Drejtoresha e re e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), një anëtare e përhershme në KI. Në fund të vitit 2023, Qeveria riaktivizoi Këshillin Ekonomik Kombëtar (KEK), duke krijuar një nevojë

Në vitin 2023,
rritja ekonomike
e Shqipërisë
arriti në 3.4%,
sipas vlerësimeve
të INSTAT.



të mëtejshme për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni midis tij dhe KI-së. Të dy këshillat ofrojnë qasje plotësuese: metoda nga poshtë-lart e KI-së, duke mbledhur shqetësimet e biznesit, plotëson vendimmarrjen nga lart-poshtë të KEK-ut, e cila përfshin konsultimin e strategjive dhe politikave ekonomike të qeverisë me sektorin privat.

DISA DINAMIKA KRYESORE LIGJORE DHE RREGULLATORE

Në mbyllje të vitit 2023, heqja e Shqipërisë nga lista gri e FATF/MONEYVAL shënoi një arritje të rëndësishme që i atribuohet përmbyshjes së disa rekomandimeve. Ky moment historik pritet të rrisë reputacionin e vendit dhe të zvogëlojë kostot e transaksioneve financiare vendase dhe ndërkombëtare nëpërmjet bankave. Gjithashtu, nisja e Programit të Reformës Ekonomike (ERP) për Shqipërinë për periudhën 2024-2026, gjatë një mbledhje të dedikuar të Këshillit të Investimeve, parashtrij reformat strukturore thelbësore për zhvillimin ekonomik dhe masat shoqërore. Në një përpjekje për të stimuluar konkurrencën në

treg dhe për të inkurajuar rritjen e pagave si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, qeveria prezantoi një plan për një rritje të konsiderueshme të pagave në sektorin publik, duke synuar një rritje të parashikuar të pagës mesatare prej 67% në 2024 krahasuar me 2022.

Pavarësisht tensioneve politike gjatë seancave të Kuvendit të Shqipërisë, buxheti dhe paketa fiskale u miratuan në dhjetor 2023. Megjithatë, procedurat patën ndërprerje, duke larguar vëmendjen nga diskutimet thelbësore. Paketa fiskale ruajti fokusin e Ministrisë së Financave në parashikueshmërinë legjislative dhe administrimin e mirë fiskal pa ndryshime të rëndësishme. Shqetësimet e ngritura nga profesionistë dhe ekspertë në lidhje me gatishmërinë dhe implikimet e “Ligjit të ri për tatimin mbi të ardhurat” (i miratuar në vitin 2023 dhe në fuqi nga 1 janari 2024) nuk u adresuan me ndryshime. Në vend të kësaj, akti nënligjor kryesor u miratua në fund të dhjetorit, i shoqëruar nga një akt normativ që i jep administratës tatimore kohë shtesë për t’u njohur me ligjin, duke konfirmuar shqetësimet e vazhdueshme për gatishmërinë e plotë për zbatimin e tij.

MBLEDHJE PLENARE



1.

Si mund të ndihmojë përmirësimi i njohurive dhe aftësive lokale të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve) në diversifikimin e burimeve të energjisë dhe uljen e kostove fillestare të projekteve për energji të rinovueshme?

Cilët janë aktorët kryesorë që mund të promovojnë dhe lehtësojnë këtë proces? Shqipëria ka burime të mëdha të energjisë së rinovueshme që e pozicionojnë atë si një potencial 'bateri të gjelbër' për rajonin e Ballkanit. Megjithatë, ndonëse ka këtë potencial, sektori privat vendas shpreh shqetësim për efikasitetin dhe koston e këtyre burimeve të reja të energjisë dhe vazhdon të hezitojë të investojë në këtë drejtim. A ka plane të qarta për zhvillimin e tregut të energjisë për të adresuar këto shqetësime të biznesit dhe për të inkurajuar investimet?

Shqipëria ka një potencial të rëndësishëm në burimet e rinovueshme, duke e pozicionuar si një lojtar kyç në tranzicionin e rajonit të Ballkanit drejt energjisë së qëndrueshme. Megjithatë, sfida të tilla si kushtet hidrologjike të luhatshme dhe diversifikimi i kufizuar i burimeve paraqesin rreziqe për sigurinë energjetike. Për të kapërcyer këto sfida, është thelbësore të inkurajohen bizneset vendase që të adoptojnë modele të reja të përqendruara rreth sipërmarrjes së gjelbër, investimeve të qëndrueshme dhe dizajnit të qëndrueshëm dhe të përshtatshëm për qarkullim të vazhdueshëm. Përveç kësaj, avokimi për politika të qëndrueshme të produkteve, zgjerimi i përgjegjësisë së prodhuesit dhe parandalimi i përhapjes së produkteve të dëmshme për mjedisin në tregun e Ballkanit Perëndimor janë të domosdoshme. Njohja e pasigurive me të cilat përballen ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) gjatë tranzicionit energjetik, duke u ofruar atyre njohuri dhe mbështetje të zgjeruar bëhet thelbësore. Për të naviguar në mënyrë efektive këtë tranzicion dhe për t'u përafëruar me objektivat e përshkruara në Strategjinë Kombëtare të Sektorit të Energjisë 2030 të Shqipërisë, nevojiten përpjekje të bashkërenduara si nga institucionet qendrore ashtu edhe ato lokale.

REKOMANDIME KRYESORE

- **Vlerësimi i instrumenteve aktuale në dispozicion të NVM-ve:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) të zhvillojnë një vlerësim të instrumenteve ekzistuese në dispozicion të NVM-ve, me fokus të veçantë në sektorët prioritarë si turizmi dhe ndërtimi. Ky vlerësim përfshin zhvillimin e një liste ndërhyrjesh me prioritet kombëtar, të përqendruar në planet e gjelbërta të NVM-ve dhe sfidat e financimit.
- **Ngritja e një qendre informacioni të centralizuar:** Krijimi i një platforme të centralizuar të menaxhuar nga MIE për të ofruar informacion dhe njohuri mbi praktikën më të mira në lidhje me energjinë e rinovueshme.
- **Angazhimi i biznesit:** Është e nevojshme të zhvillohet një angazhim proaktiv nga dhomat e biznesit, universitetet dhe qendrat e njohurive për të rritur ndërgjegjësimin dhe kapacitetet menaxhuese të NVM-ve për energjinë.
- **Ndërhyrje ligjore:** MFE dhe MIE të paraqesin ndryshime ligjore për të rritur adoptimin e energjisë së rinovueshme, duke përfshirë rritjen e kapacitetit të prodhues-konsumatorëve.

Krahas strategjive dhe ligjeve të reja që po miratohen, është e nevojshme ngritja e grupeve të punës dhe një qasje proaktive ndërmjet institucioneve dhe dhomave të biznesit për të mundësuar shkëmbimin e informacionit, jo vetëm për stimujt fiskalë në sektorin e energjisë, por edhe përsa i përket termave teknike dhe zbatimit praktik të tyre. Edhe pse NVM-të disponojnë burime financiare për investime, shumë prej tyre nuk i kuptojnë këto mundësi dhe nuk kanë informacion të mjaftueshëm për modele të duhura të investimeve.

Klodiana Ajazi,

Dhoma Ekonomike e Gruas, 31 janar 2023

MBLEDHJE PLENARE



2.

A ka ardhur koha që sipërmarrësit të zhvendosin vëmendjen e tyre drejt rritjes së produktivitetit në vendin e punës si një masë kritike për sigurimin e qëndrueshmërisë së biznesit të tyre?

Duke pasur parasysh kapacitetin e kufizuar të kompanive për të përmirësuar teknologjinë dhe për të rritur konkurrencën në një shkallë më të gjerë, a ka nevojë urgjente për mbështetje shtesë nga institucionet financiare dhe për zbatimin e instrumenteve të mbështetura nga shteti?

Mënyra aktuale e rritjes së paqëndrueshme të pagave, pa përmirësime të njëkohshme në produktivitet dhe cilësi, mund të çojë në sfida të konkurrencës dhe potencialisht të paraqesë rrezeqe strukturore për bizneset, të cilat mund të kërkojnë kohë të konsiderueshme për t'i kapërcyer:

Pavarësisht përparimeve në digjitalizim dhe tregues të tjerë makro, Shqipëria përballlet me sfida në ekonominë e saj, të karakterizuara nga nivele të ulëta të sofistikimit të biznesit, inovacionit dhe njohurive sipërmarrëse në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Ndikimi i ligjeve për pagën minimale në ekonomi dhe punësim është kompleks dhe varet nga faktorë si niveli i pagës minimale, qëndrueshmëria ekonomike dhe konkurrueshmëria e industrisë. Nga këndvështrimi i sektorit privat vendas, një pagë minimale më e lartë mund të shihet si një hap pozitiv në mesin e mungesës së tregut të punës. Megjithatë, çfarë mendojnë sipërmarrësit vendas? Efekti i pagave në konkurrencën e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) varet nga faktorë si dinamika e industrisë dhe strategjitë e biznesit. Trajtimi i këtyre çështjeve mund të kërkojë kombinimin e politikave të pagës minimale me masa përkatëse për të promovuar praktikat moderne të sipërmarrjes dhe për të lehtësuar programet e trajnimit dhe zhvillimit. Kjo siguron që punonjësit të kenë aftësitë e nevojshme për rritje të qëndrueshme ekonomike.

REKOMANDIME KRYESORE

- **Ndërhyrje lokale për Kulturën e Punës dhe Punësimin:** MFE-ja dhe zyrat e punësimit duhet të priorizojnë ndërhyrjet lokale që synojnë përmirësimin e kulturës së punës dhe ofrimin e mundësive për punësim të denjë. Kjo përfshin edukimin e punonjësve dhe punëdhënësve të ardhshëm në lidhje me legjislacionin e punës dhe kontratat e punës, duke u fokusuar në të drejtat dhe detyrimet e tyre.
- **Indeksi i pagave:** Qeveria Shqiptare, në bashkëpunim me partnerë socialë, duhet të angazhohet në një proces gjithëpërfshirës për të vlerësuar miratimin e një mekanizmi të indeksimit të pagave si për sektorin publik ashtu edhe për atë privat çdo vit.
- **Kontribute proporcionale të sigurimeve shoqërore dhe paga të drejta për punësimin me kohë të pjesshme:** Rekomandohet që MFE, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH) të implementojnë kontribute proporcionale për sigurimet shoqërore të punonjësve me kohë të pjesshme dhe të mbrojnë të drejtën për paga të denja orare. Punonjësit me kohë të pjesshme duhet të marrin paga ekuivalente me punonjësit me kohë të plotë, të llogaritura bazuar në tarifën mujore, javore ose ditore sipas ligjeve të punës. Gjithashtu, paga për punë jashtë orarit nuk duhet të përfshihet në llogaritjen e pagës minimale, pasi shkel rregullat për të kërkuar punën jashtë orarit për arritur pagën minimale ligjore. Në vend të kësaj, punonjësve me kohë të pjesshme duhet t'u garantohet një pagë minimale proporcionale me orët e tyre të punës.



Eshtë thelbësore të krijohet një paketë kombëtare ose një plan veprimi që synon rritjen e produktivitetit dhe konkurrencës. Të gjitha grupet e interesit dhe operatorët ekonomikë duhet të mendojnë për rritjen e pagave në vend dhe të kenë një qasje të koordinuar në lidhje me indeksimin e pagave në sektorin publik. Fatkeqësisht, ky fenomen tashmë është bërë realitet. Në diskutimin e produktivitetit, duhet të adresohen disa elemente kyç: Së pari, disponueshmëria e fuqisë punëtore paraqet një sfidë të rëndësishme. Sektori i prodhuesve mbetet i prekur nga rritja e pagës minimale, duke përfshirë nivelet minimale dhe mesatare të pagave që u tejkalojnë katër vjet më parë. Aktualisht, 99.8% e sipërmarrjeve në vend janë biznese mikro dhe të vogla dhe subjekte individuale, gjë që tregon nevojën për më shumë prodhues dhe ofrues shërbimesh. Së dyti, punonjësit duhet të kenë aftësitë e nevojshme për të merituar pagën e tyre të kërkuar. Sfidat lindin me fluksin e fuqisë punëtore të pakualifikuar. Arsimi profesional paraqet një sfidë, pasi punonjësit e rinj shpesh nuk kanë kualifikime të mjaftueshme, por kërkojnë paga joproporcionale. Së fundmi, Shqipëria është bërë pjesë e qarkullimit global të punonjësve, duke pritur punëtorë të huaj që qëndrojnë në vend për një kohë të shkurtër, si për shembull pesë ditë.

Arben Shkodra, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë, 18 prill 2023



MBLEDHJE PLENARE



3.

A ka ardhur koha

që sipërmarrësit të kthejnë sytë drejt përthithjes së digjitalizimit si një mekanizëm për integrimin ekonomik, pasi tashmë është provuar lidhja direkte midis tij dhe rritjes së produktivitetit të ndërmarrjeve dhe konkurrueshmërisë?

Digjitalizimi

nuk duhet të konsiderohet si një qëllim në vetvete, por një mekanizëm për të përmirësuar performancën e administratës publike në ofrimin e shërbimeve publike me kosto optimale.

Perceptimet e biznesit në lidhje me sigurinë e të dhënave, përdorueshmërinë e platformës, kanalet e ankesave dhe saktësinë e përgjigjeve institucionale vazhdojnë të paraqesin sfida. Gjithashtu, pavarësisht vlerësimeve publike, ruajtja e stabilitetit institucional, koordinimi dhe ofrimi i trajnimit adekuat digjital dhe edukimi i vazhdueshëm për stafin administrativ mbetet problematik:

Në diskutimet për përmirësimin e mjedisit të biznesit në vend, reduktimi i barrës administrative dhe korrupsionit njihet gjithnjë e më shumë si faktor vendimtar. Përpjekjet për digjitalizimin e shërbimeve publike, veçanërisht atyre që ofrojnë shërbime për biznesin, janë intensifikuar dhe koordinuar nëpërmjet masave të ri-inxhinierimit dhe derregullimit. Qëllimi është të thjeshtohet ofrimi i shërbimeve, të zvogëlohet koha e përpunimit dhe të lehtësohen procedurat. Investimet gjatë krizës COVID-19 në infrastrukturën e TIK-ut dhe platformat e ndërveprimit elektronik, si platforma e-Albania, kanë përmirësuar funksionimin efikas të shërbimeve publike, duke sjellë përfitime edhe për bizneset. Megjithatë, edhe pse ka progres të dukshëm, vazhdojnë të ekzistojnë sfida të rëndësishme. Këto përfshijnë çështje teknike dhe shqetësime themelore, si humbja e afateve, përgjigje administrative të paqarta, trajtim jokonsistent i çështjeve dhe paqartësi rreth ankesave administrative. Adresimi i këtyre sfidave kërkon vëmendje të përqendruar dhe përafrim me përpjekjet e vazhdueshme për të përmirësuar proceset e derregullimit dhe ri-inxhinierimit.

REKOMANDIME KRYESORE

- **Mbështetje për digjitalizimin dhe edukimin digjital të NVM-ve:** Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes (MSHMS), Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investime (AIDA), dhomat e tregtisë, shoqatat e biznesit dhe partnerët për zhvillim duhet të ofrojnë mbështetje të fuqishme për digjitalizimin dhe edukimin digjital të bizneseve, me fokus të veçantë tek NVM-të.
- **Përmirësimi i Sistemeve të Pagesave Online për Shërbimet Administrative Qendrore:** Zëvendëskryeministri, MSHMS, AKSHI, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB), Agjencia e Ofritit të Shërbimeve të Integruara (ADISA), Banka e Shqipërisë dhe Shoqata e Bankave duhet të bashkëpunojë për të përmirësuar sistemet e pagesave online, të paktën për shërbimet administrative qendrore.
- **Ri-inxhinierimi i praktikave administrative për depozitimin e pasqyrave financiare:** Zëvendëskryeministri, MSHMS, AKSHI, DPT, QKB, ADB dhe Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) duhet të bashkëpunojë për të riinxhinieruar praktikën dhe procedurat administrative për depozitimin e pasqyrave financiare. Nëpërmjet përdorimit të dixhitalizimit, këto përpjekje synojnë të ulin barrën administrative si për bizneset ashtu edhe për administratën publike.



Ka disa sfida kryesore me të cilat përballet biznesi sot. Së pari, krijimi i një “dritare të vetme” për import dhe eksport është parësor për bizneset e angazhuara në tregtinë ndërkombëtare. I bëj thirrje institucioneve përkatëse, përfshirë Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të marrin masa vendimtare për arritjen e këtij qëllimi dhe të ndihmojnë bizneset në marrjen e licencave për tregtinë ndërkombëtare. Së dyti, shumë biznese hasin pengesa në marrjen e statusit të ‘eksportuesit të autorizuar’. Për këtë arsye, nevojitet mbështetje për trajnim dhe informacion më i detajuar mbi procedurat. Së treti, në lidhje me tregtinë elektronike, ekziston një nevojë urgjente për zhvillimin e infrastrukturës për të lehtësuar përpunimin e dokumenteve elektronike, nënshkrimin digjital dhe kryerjen e pagesave online. Ndërsa ka njëfarë progresi në këtë drejtim, theksoj rëndësinë e adresimit të kërkesave të biznesit për të përmirësuar më tej këtë proces thelbësor.

Ines Muçostepa,
Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, 6 tetor 2023

PLENARY MEETINGS



4.

ERP fokusohet

në promovimin e energjisë së rinovueshme, infrastrukturës digjitale dhe transportit të qëndrueshëm. Ai trajton integrimin ekonomik, kërkimin dhe inovacionin, luftën kundër informalitetit dhe mbështetjen për startup-et. Masat përfshijnë përmirësimin e aksesit në shërbimet elektronike, rritjen e aftësive digjitale dhe zhvillimin e një kuadri ligjor për bizneset startup.

Programi i Reformës Ekonomike (ERP) për 2024-2026, i përgatitur nga Qeveria Shqiptare, shërben si udhërrëfyes për qeverinë për prioritetizimin dhe zbatimin e reformave të nevojshme ekonomike. Ndryshe nga vitet e kaluara, ERP 2024-2026 përmban tre grupe tematike: kapitali njerëzor, qëndrueshmëria dhe rimëkëmbja dhe konkurrueshmëria. Reformat strukturore të propozuara përfshijnë arsimin, mbrojtjen sociale, energjinë e rinovueshme, transformimin digjital dhe përmirësimin e klimës së biznesit. Ky dokument është vendimtar për Planin e Ri të Rritjes së Komisionit Evropian, i cili përfshin një fond prej 6 miliardë eurosh për Ballkanin Perëndimor.

DISA SUGJERIME KRYESORE TË NGRITURA GJATË MBLEDHJES

- **Përfshirja e Sektorit Privat:** Reformat duhet të hartohen me pjesëmarrje aktive të sektorit privat, duke u ofruar atyre një platformë si Këshilli i Investimeve për të shprehur shqetësimet e tyre. Kjo përfshirje siguron mundësi për sektorin privat, veçanërisht për aksesin e drejtpërdrejtë në tregun e përbashkët dhe për integrimin në tregun rajonal.
- **Përafrimi me Programin e Reformës dhe Rritjes:** Është thelbësore që reformat e parashikuara në ERP të harmonizohen me Planin e Rritjes të Komisionit Evropian. Kjo do të shmangte mesazhet kontradiktore dhe do të siguronte një qasje koherente drejt përmbytjes së objektivave të zhvillimit. Edhe pse ERP mund të ketë nuanca specifike, veçanërisht në frontin social, ka mbivendosje të konsiderueshme me Planin e Rritjes. Prandaj, rekomandohet përdorimi i ERP-së si një dokument themelor për t'u integruar në Planin e Rritjes. Ndërkohë që ERP-ja nuk përfshin aspekte financiare, zbatimi dhe realizimi i reformave të përfshira është vendimtar për disbursimin e fondeve të Planit të Rritjes.
- **Kapaciteti për Zbatimin e Iniciativave të Infrastrukturës në Shkallë të Gjerë:** Duhet t'i kushtohet vëmendje kapacitetit për zbatimin e projekteve të infrastrukturës në shkallë të gjerë që respektojnë standardet ndërkombëtare dhe ato të BE-së. Vonesat në zbatimin e projektit shpesh lindin për shkak të përputhshmërisë me standardet e BE-së në lidhje me ndikimet mjedisore dhe sociale, prokurimin dhe më shumë. Për të zgjidhur këtë, është e rëndësishme të sigurohet qasje e shpejtë në asistencë teknike. Si pjesë integrale e projektit, qasja në kohë në një ndihmë të tillë rrit mundësinë e zbatimit të tij brenda kornizës kohore të caktuar.
- **Reforma për Pronësinë e Tokës:** Reforma e vazhdueshme për pronësinë e tokës mbetet një pengesë kryesore për investimet në sektorë të rëndësishëm si bujqësia, turizmi dhe energjia. Për të lehtësuar zhvillimin në këto fusha, është e nevojshme të merren masa të menjëhershme për të zgjidhur këtë çështje.



Zinxhiri i propozuar i aktiviteteve dhe treguesve për matje të përfshira në draftin e ERP-së është i përshtatshëm, duke e bërë atë një dokument gjithëpërfshirës. Megjithatë, përfshirja e diasporës do të ishte shumë e dobishme, duke pasur parasysh ndikimin e saj të rëndësishëm në kapitalin njerëzor dhe potencialin për investime. Unë sugjeroj nxitjen e konkurrencës përmes një qasjeje të koordinuar midis koncepteve “Made in Albania” dhe “Made by Albanians”. Kjo mund të inkurajojë konsumatorët e diasporës që të mbështesin produktet vendase dhe të krijojnë partneritete me sektorin privat për të rritur imazhin e vendit dhe për të tërhequr investime.

Në lidhje me ‘ri-aftësimin’, ka një nevojë urgjente për zbatimin e një politike të specializuar ‘ri-kualifikimi’ për sektorët që përballen me kriza. Përveç kësaj, bashkëpunimi strategjik në nivel lokal me bashkitë mund të rrisë cilësinë e fuqisë punëtore.

Për sektorin privat, përpjekjet bashkëpunuese për përmirësim, automatizim, standardizim dhe digjitalizim janë thelbësore për të konkurruar në mënyrë efektive në tregjet ndërkombëtare. Prandaj, rekomandohet përfshirja e NVM-ve në iniciativë të tilla si Shqipëria Inteligjente dhe Agjencia për Inovacion dhe Ekselencë. Kjo qasje synon të nxisë inovacionin dhe t'i pajisë ato për të adresuar sfidat ndërkombëtare.

Elisabeta Katiaj,
Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare, 15 dhjetor 2023

KONSULTIME



Adresimi i Sfidave Energjitike të NVM-ve përmes Konsultimit Gjithëpërfshirës

Konsultim me aktorë të sektorit publik dhe private mbi sfidat me të cilat përballen ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) në kalimin në burime alternative të energjisë. Procesi përfshinte:

- Katër mbledhje fokus grup me 46 kompani
- 15 intervista individuale me aktorë të sektorit publik dhe privat
- Një anketë me 75 kompani

Këto konsultime ofruan njohuri dhe rekomandime të vlefshme, të cilat u përmbledhën në notën teknike të Sekretariatit dhe më pas u diskutuan në mbledhjen e Këshillit. Gjetjet kryesore identifikuan sfida specifike dhe zgjidhje të propozuara për NVM-të që synojnë të përdorin burime alternative të energjisë.

Iniciativa dhe Sfida në Shërbimet Publike Digjitale ndaj Biznesit

Sekretariati bashkëpunoi me Dhomën Ekonomike të Gruas dhe Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për të bashkë-organizuar dy mbledhje fokus grup me komunitetin e biznesit, ndërsa një mbledhje e veçantë u mbajt me ekspertë të pavarur të fushës. Këto sesione iu dedikuan diskutimit të gjetjeve para-prake të një vrojtimi mbi cilësinë e shërbimeve publike digjitale të kryer online nga Sekretariati me 324 kompani të sektorit privat. Në këto sesione morën pjesë:

- 50 përfaqësues të sektorit privat
- Përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

Pjesëmarrësit vunë në dukje se ndërsa shërbimet digjitale kanë ulur kostot administrative, disa probleme me platformën e-Albania vazhdojnë. Rekomandimet përfshinin:

- Përmirësime në platformën aktuale të e-Albania.
- Zhvillimi i platformave të veçanta në e-Albania për qytetarët dhe bizneset për të siguruar një eksperiencë më të mirë dhe efektive për përdoruesit.

REKOMANDIME TË PËRMBUSHURA GJATË VITIT 2023



KI ka analizuar dhe miratuar 326 rekomandime për përmirësimin e klimës së investimeve në Shqipëri gjatë periudhës 2015-2023. Kjo është realizuar përmes një dialogu efektiv publik-privat. Sekretariati ka ndjekur një qasje transparente, duke publikuar përditësime të vazhdueshme mbi progresin e rekomandimeve dhe duke rritur ndërgjegjësimin rreth punës së tij për një bashkëpunim sa më të gjerë në mesin e partnerëve dhe palëve të interesuara. Megjithatë ka një përshpejtim të dukshëm në reagimin e institucioneve publike lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Këshillit, cilësia e përgjigjeve të mbërritura mbetet ende e kufizuar.

Statusi i zbatimit të rekomandimeve:

- » 47.5% e rekomandimeve janë zbatuar plotësisht (70-100%)
- » 16.6% janë në proces zbatimi
- » 35.9% janë ende të papërmbyshur

Ndikimi i Rekomandimeve në disa Fusha Kryesore:

- » **Ndikimi në Fusha Kryesore:** Adresimi i sektorëve të ndryshëm, duke përfshirë Energjinë, Bujqësinë, Turizmin, Punësimin dhe Inovacionin përmes nëntë nismave legislative. Në vitin 2023, janë ndërmarrë 11 nisma legislative për të zbatuar këto ndryshime.
- » **Promovimi i Turizmit:** Promovimi aktiv i investimeve turistike në përputhje me planet e zhvillimit ekonomik dhe urban, duke u fokusuar në Zonat e Zhvillimit me Prioritet Kombëtar. Në këto përpjekje përfshihet gjithashtu menaxhimi dhe zhvillimi i zonave të mbrojtura si Parku Kombëtar i Vjosës.
- » **Sektori i Bujqësisë:** Iniciativa për të rritur saktësinë në hartën e tokës dhe për të qartësuar të drejtat e pronësisë. Përpjekjet për të integruar zinxhirin e vlerës dhe për të siguruar një furnizim të qëndrueshëm të lëndëve të para për agro-përpunimin janë mbështetur përmes AZH-BR-së në kuadër të programit IPARD II.
- » **Energjia e Rinovueshme:** Përparime të rëndësishme përfshijnë zbatimin e një tregu të liberalizuar të energjisë dhe shkëmbimit të energjisë. Dispozitat për të inkurajuar burimet e rinovueshme të energjisë janë forcuar, përfshirë këtu përmirësimet në skemën e matjes neto.
- » **Mbështetje për edukimin e NMVM-ve:** Programe trajnimi për NMVM-të për të rritur kapacitetet në fusha të ndryshme, përfshirë menaxhimin e mbetjeve, përdorimin e sistemeve fotovoltaike, efikasitetin e energjisë dhe bazat e menaxhimit financiar.
- » **Përfshirja e komunitetit të biznesit:** Përfshirja e shoqatave të biznesit dhe sindikatave si pjesë e Këshillit Kombëtar të Punës për të mundësuar ndikimin në vendimmarrje.
- » **Ndryshime në shpërbimin e punonjësve:** Miratimi i një mekanizmi të indeksimit të pagave dhe fillimi i një plani për rirregullimin e pagave në administratën publike. Rritje të ndjeshme të pagave vërehen në sektorin publik.
- » **Monitorimi i pajtueshmërisë tatimore:** Krijimi i një Komiteti të Riskut për monitorimin e pajtueshmërisë së tregut nga administrata tatimore.
- » **Cilësia e Shërbimeve Publike:** Krijimi i "Agjencisë së Inovacionit dhe Ekselencës" për të sugjeruar dhe mbikëqyrur vazhdimisht zbatimin e zgjidhjeve inovative për rritjen e shërbimeve publike.
- » **Bashkëpunimi universitet-biznes:** Forcimi i marrëdhënieve mes universiteteve dhe bizneseve nëpërmjet marrëveshjeve bashkëpunuese, nxitjes së interesit dhe ndërgjegjësimin në këtë drejtim.


Lexo më shumë, [Raporti i Monitorimit të Rekomandimeve të KI, 2023](#).

Forcimi i zbatimit të Reformave

Zbatimi i rekomandimeve të KI është lehtësuar dhe forcuar në sajë të mbështetjes me projekte vijuese nën drejtimin e BERZH-it dhe mbështetjes së Sekretariatit Shtetëror Zvicerian për Çështjet Ekonomike (SECO).

KI ka përforcuar zbatimin e rekomandimeve të tij përmes mbështetjes së ofruar nga BERZH me projekte vijuese. Një nismë e ndërmarrë gjatë 2023 u fokusua në adresimin e një rekomandimi të vitit 2020 drejtuar Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) dhe Agjencisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (AZHBR) në lidhje me përditësimin e informacionit mbi tregun e produkteve të freskëta dhe të përpunuara. Në këtë kuadër, BERZH ofroi mbështetje teknike për zbatimin

e këtij propozimi. Gjatë vitit, pati progres për-sa i përket: (1) lançimit të portalit e-Fermeri, një platformë miqësore për përdoruesit, e cila ofron informacion të plotë dhe të përditësuar, të rëndësishëm për agrobizneset dhe fermerët, dhe (2) përfundimit të përpjekjeve për ngritjen e kapaciteteve të AZHBR-së, duke rritur aftësitë e saj institucionale në përputhje me direktivat e BE-së dhe agjencisë IPARD. Këto përpjekje synonin të thjeshtonin përpunimin e aplikimeve për financimin e fermerëve për rezultate më të shpejta dhe më efikase.



Komunikim dhe Vizibilitet



Faqja e internetit:

» +20,000 përdorues në 2023

Mediat Sociale:

» Aktiv në 3 platforma: Facebook, Twitter, LinkedIn
» Rritje prej 19.4% në numrin e ndjekësve: (4,013 në 2023 vs 3,360 në 2022)

Buletinë Tremujorë

Shpërndarë në mënyrë elektronike tek të gjithë partnerët e KI-së dhe postuar në mediat sociale.

» Buletini, Janar-Mars 2023
» Buletini, Prill-Qershor 2023
» Buletini, Korrik-Shtator 2023
» Buletini, Tetor-Dhjetor 2023

Artikuj në Median e Shkruar

- Intervistë e znj. Diana Leka, Drejtore e Sekretariatit "Vizioni i të Ardhmes të jenë Investimet që Ndikojë Pozitivisht Ekonominë" – Revista Monitor, 13 janar 2023
- Vetëprodhuesit e Fotovoltaikëve, KI rekomandon rritjen e kapacitetit deri 1 MW – Revista Monitor, 6 mars 2023
- Rekomandimet e Këshillit të Investimeve, raporti: Ministria e Turizmit dhe Kadastra m: Ministria e Turizmit dhe Kadastra më pasivët – Revista Monitor, 5 prill 2023
- Mblidhet Këshilli i Investimeve! Ministri Mete fton bizneset të marrin pjesë në konsultimet për projektbuxhetin 2024 dhe paketën fiskale – TopChannel, 6 tetor 2023

Prezencë Mediatike në Kanalet Kombëtare Televizive

- » **Top Channel**
- Top News – Dy ligje për energjinë / Dy limite të ndryshme për vetëprodhuesit –

Top Channel, 7 mars 2023

- Top News – 'Bizneset mbështesin rritjen e pagës' / Ibrahimaj prezanton anketën e Këshillit të Investimeve – Top Channel, 18 prill 2023
- » **RTV Klan**
 - Pro Business – Sfidat e NVM-ve drejt burimeve alternative të energjisë – RTV Klan, 6 shkurt 2023
 - Ibrahimaj: Biznesi mbështet rritjen e pagave – RTV Klan, 18 prill 2023
- » **Scan TV**
 - Mblidhet Këshilli i Investimeve, biznesi pro rritjes së pagave – Scan TV, 18 prill 2023
 - "Biznesi të jetë i përfshirë në reformat ekonomike" – Mete: Shqipëria përfiton 1 miliard euro nga BE – Scan TV, 15 dhjetor 2023
- » **National Radio Television (RTSH)**
 - Ibrahimaj në Këshillin e Investimeve: Biznesi mbështet rritjen e pagës minimale – RTSH, 18 prill 2023
 - Mblidhet Këshilli i Investimeve, nisin konsultimet e Programit të Reformave Ekonomike 2024-2026 – RTSH, 15 dhjetor 2023
- » **BalkanWeb**
 - Ministri Mete në Këshillin e Investimeve: Bizneset, pjesë e konsultimeve për paketën fiskale – BalkanWeb, 6 tetor 2023
 - Mete mbledh Këshillin e Investimeve, nis konsultimi i Programit të Reformave Ekonomike 2024-2026 – BalkanWeb, 15 dhjetor 2023

Marketing me e-mail (shpërndarja e njoftimeve për shtyp)

- 1,100 të abonuar
- Shpërndarë në anglisht dhe shqip
- 22% mesatarja e leximit të njoftimeve

ANGAZHIMI I PARTNERËVE

Gjatë vitit 2023, 155 kompani morën pjesë në aktivitetet e ndryshme të KI-së. Diskutime teknike u realizuan në nivel ekspertësh për të eksploruar dhe validuar aspekte të ndryshme teknike, ndërsa tre anketat e Sekretariatit arritën një pjesëmarrje të gjerë. Së bashku me mbledhjet plenare, këto bashkëpunime luajtën një rol të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit të palëve të interesuara për iniciativat e KI dhe në nxitjen e komunikimit nëpër forume të ndryshme. Një risi për këtë vit ka qenë partneriteti i KI me institucione të tilla si Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) për organizimin e një takimi fokus grup mbi shërbimet publike digjitale të ofruara për biznesin.

SHIFRA KRYESORE GJATË 2023

- » **155 përfaqësues të biznesit** morën pjesë në mbledhje të KI dhe mbledhje teknike
- » **4 mbledhje të KI** u drejtuan nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë me një nivel pjesëmarrje të anëtarëve prej **85%**
- » **4 takime teknike (fokus grup)** me pjesëmarrjen e **63 përfaqësuesve të biznesit dhe ekspertëve të pavarur**
- » **3 anketa:**
 - Anketë "Mbi pasiguritë e sipërmarrësve vendas për diversifikimin e energjisë" (75 kompani)
 - Anketë "Paga minimale dhe produktiviteti" (506 kompani)
 - Anketë "Cilësia e Shërbimeve Publike Digjitale sipas Këndvështrimit të Biznesit" (324 kompani)
- **Pjesëmarrja gjinore në aktivitetet e KI:** 57% gra, 43% burra
- Shoqatat dhe dhomat e biznesit, anëtarë të KI, përfaqësuan **interesat e 1,319 kompanive.**



AVOKIM DHE NDËRGJEGJËSIM

Kontribut në Planin Kombëtar të Partneritetit për Qeverisjen e Hapur (OGP) 2022-2023

16 janar 2023

Me ftesë të Zyrës së Kryeministrit, Sekretariati u ftua të kontribuojë në finalizimin e angazhimeve të Planit Kombëtar për Partneritetin e Qeverisjes së Hapur (OGP) krahas aktorëve të tjerë—përfaqësues të shoqërisë civile. Angazhimet e sapoformuluara u fokusuan në politikëbërjen efektive bazuar në të dhëna si planifikimi i legjisllacionit, vlerësimi i ndikimit rregullator (VNR) dhe konsultimi publik. Gjatë diskutimit, Sekretariati theksoi rolin e konsultimit publik në rritjen e transparencës dhe efikasitetit rregullator. Ai gjithashtu avokoi për zbatimin e rekomandimeve të Mbledhjes XXVII të Këshillit të Investimeve, të cilat mbështesin përmirësimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik.

Avokim për Adresimin e Sfidave të Tregut të Punës për të Rinjtë

27 shkurt 2023

Sekretariati kontribuoi në një Tryezë të Rrumbullakët Rajonale të organizuar nga Rrjeti i Profesionistëve të Rinj (YPN) për të adresuar sfidat me të cilat përballen të rinjtë në tregun e punës. Gjatë diskutimit, Sekretariati theksoi rëndësinë e përpjekjeve të vazhdueshme të BE-së dhe Bankës Botërore si dhe nismave të drejtuara nga qeveria në trajtimin e këtyre çështjeve dhe theksoi rolin kritik të angazhimit të të rinjve në kapërcimin e barrierave dhe në formësimin e politikave. Gjithashtu, Sekretariati theksoi bashkëpunimin e frytshëm të KI me YPN dhe Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës (FEUT) për identifikimin e shqetësimeve dhe njohurive kryesore të të rinjve dhe për t'i bërë ata pjesëmarrës në dialogun publik-privat me qëllim mbështetjen e integritetit të profesionistëve të rinj në tregun e punës.

Kontribut në Forumin Ekonomik: “Klima e biznesit, produktiviteti dhe kapitali njerëzor”

24 prill 2023

Drejtuësja e Sekretariatit mori pjesë si paneliste në seancën plenare me titullin “Rritja e Qëndrueshme dhe Klima e Favorshme e Biznesit” në Forumin Ekonomik. Kjo ftesë, e bërë nga Ministria e Shtetit për Standardet dhe Shërbimet, znj. Milva Ekonomi, ofroi një mundësi të shkëlqyer për Sekretariatit për të prezantuar punën e KI gjatë viteve 2015-2023. Në fjalën e saj, znj. Leka theksoi angazhimin e KI në mbështetje të sipërmarrjes për optimizimin e kostove të lidhura me integrimin në zinxhirin global të vlerës dhe për nxitjen e inovacionit, si dhe për adresimin e sfidave të ndryshme me të cilat ballafaqohen. Edhe pse ka rritje të mundësive në tregun global dhe përmirësim në shërbimet publike digjitale në kohët e fundit, studimet e Sekretariatit tregojnë se madhësia e vogël e biznesit, produktiviteti i ulët dhe aksesit i kufizuar në financë vazhdojnë të jenë faktorë strukturorë kryesorë që pengojnë integrimin e NVM-ve shqiptare në zinxhirët globalë dhe tregjet e eksportit.

Rritje të Mbështetjes për Sektorin Privat: Çështje Kryesore nga Takimi i Grupit të Financuesve të Projektit WBIF

24-25 maj 2023

Grupi i Financuesve (PFG) të Projektit WBIF u mbledh në Bruksel. Me ftesë të Qeverisë Shqiptare, Drejtorja e Sekretariatit kontribuoi në një sesion të dedikuar mbi mbështetjen e mundshme për sektorin privat nëpërmjet instrumentit të ardhshëm WBIF. Gjatë fjalës së saj, Drejtuesja e Sekretariatit prezantoi disa evidenca të KI mbi këndvështrimin e sipërmarrësve vendas në lidhje me inovacionin, aksesin në financë, nevojën për koordinim institucional dhe harmonizim të sistemit arsimor. Ajo theksoi gjithashtu se përa-



frimi i Agjendës së Gjellbër dhe Digjitale të BE-së me pikëpamjet e sipërmarrësve vendas do të maksimizonte përfitimet dhe do të ndihmonte Ballkanin Perëndimor të përthithë sa më shumë ndihmën e ardhshme.

Sekretariati Emërohet me Dekret të Kryeministrit si Vëzhgues në Grupin e Punës për Përgatitjen e Udhërrëfyesit të SDG

12 korrik 2023

Drejtorja e Sekretariatit mori pjesë si vëzhgues në mbledhjen inauguruese të grupit ndërinstytucional të punës të ngarkuar nga Kryeministri për hartimin e një udhërrëfyesi për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) brenda vitit. Ky grup, i kryesuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC), përbëhet nga përfaqësues nga ministri të ndryshme dhe institucione kyçe. Objektivi i tyre është të identifikojnë dhe formulojnë mjete për zbatimin e masave që synojnë realizimin e SDG-ve.

Bashkëpunim me INSTAT për përmirësimin e klimës së biznesit

18 gusht 2023

KI dhe Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT) nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi (MM) që synon përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri. Ky bashkëpunim mbështetet në nisja të bazuara në të dhëna zyrtare dhe ofron

një kornizë gjithëpërfshirëse për shkëmbimin e informacionit dhe ekspertizës ndërmjet dy institucioneve. Memorandumi përshkruan planet për aktivitete dhe forume të përbashkëta dhe mbështet mekanizmin monitorues të Sekretariatit për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të KI-së.

Fuqizimi i Grave Sipërmarrëse: Kontributi i KI në Samitin e Gruas së Diasporës Shqiptare

15 shtator 2023

Drejtuësja e Sekretariatit mori pjesë në Samitin e Katërt të Gruas së Diasporës Shqiptare, një ngjarje e rëndësishme e organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare (ADBC), një anëtare e përhershme e biznesit në KI-së. Me temën “Me mendje dhe zemër për Shqipërinë”, samiti nxit bashkëpunimin midis partnerëve me njohuri si Qendra për Ndërmarrjet Ndërkombëtare Private (CIPE), Bashkëpunimi Gjerman (GIZ) dhe organizata të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Veprimtaria mbledhi mbi 130 gra, duke përfshirë përfaqësues të nivelit të lartë nga Shqipëria dhe Kosova, profesionistë, drejtues biznesi, akademikë dhe organizata ndërkombëtare, me 450 pjesëmarrës të tjerë që u bashkuan online. Gjatë Panelit të Ekonomisë Dixhitale, Drejtuesja e Sekretariatit theksoi sfidat me të cilat përballen gratë sipërmarrëse vendase, veçanërisht në përvetësimin e aftësive dixhitale dhe përdorimin efektiv të platformave dixhitale. Ajo gjithashtu avokoi për mbështetjen e qëndrueshme të diasporës në adresimin e këtyre sfidave.


ANKETAT E KI GJATË 2023

Vështrime të Biznesit mbi Diversifikimin e Energjisë, Pagat-Produktivitetin dhe Shërbimet

Sondazhet janë instrumente të vlefshme për angazhimin dhe gjithëpërfshirjen e biznesit (sipas metodologjisë poshtë-lart), tashmë pjesë e punës së KI-së që prej vitit 2015. Në vitin 2023, KI realizoi tre vrojtime, duke mbledhur përgjigje nga 905 kompani nëpërmjet pyetësorëve të strukturuar të përgatitur nga Sekretariati. Vrojtimit nxorën në pah gjetje të rëndësishme, ku ndër to përmendim:

Diversifikimi i Energjisë: Ulja e kostove të energjisë dhe rritja e sigurisë në furnizim me energji janë faktorët vendimtarë që do të ndikojnë biznesin në marrjen e vendimit të investimit në efikasitet/burime alternative të prodhimit të energjisë; kurse koha e kthimit të investimit është faktori që do të kishte ndikimin më të ulët në marrjen e këtij vendimi.


Cili nga faktorët do të ndikonte më shumë në vendimin tuaj për të investuar në efikasitetin e energjisë dhe/ose burimet alternative të prodhimit të energjisë?



Anketa e Sekretariatit "Pasigurtë e sipërmarrësve vendas mbi diversifikimin e energjisë" (2023)


Paga minimale dhe produktiviteti: Kompanitë nuk perceptojnë rritje të produktivitetit në punë si rezultat i rritjes së pagës minimale, vetëm 18% e tyre perceptojnë rritje të produktivitetit, shërbime dhe turizëm.

A mendoni se rritja e pagës minimale ka ndikuar produktivitetin në punë të fuqisë punëtore?



Anketa e Sekretariatit "Paga Minimale dhe Produktiviteti" (2023)

Cilësia e Shërbimeve Publike Dixhitale: Biznesi në përgjithësi është i kënaqur me ofrimin e shërbimeve publike elektronike të cilat kanë ndikuar në uljen e barrës administrative dhe praktikave korruptive. Megjithatë, vërehet një mungesë e digjitalizimit në nivel vendor, ku shërbimet elektronike konsiderohen në nivel bazik nga ana e sipërmarrjes.



Anketa e Sekretariatit "Cilësia e Shërbimeve Publike Digjitale sipas Këndvështrimit të Biznesit (2023)

DOKUMENTE

JANAR 2023

- » [Mbledhje XXIX - Axhenda](#)
- » [Mbledhje XXIX – Prezantim PPT](#)
- » [Mbledhje XXIX – Dokument Pune “Sfidat e NVM-ve në Kalimin drejt Burimeve Alternative të Energjisë”](#)
- » [Mbledhje XXIX – Matrica e Rekomandimeve](#)
- » [Mbledhje XXIX – Minutat](#)

PRILL 2023

- » [Mbledhje XXX - Axhenda](#)
- » [Mbledhje XXX – Prezantim PPT](#)
- » [Mbledhje XXX – Dokument Pune “Nga Pagat e Ulta tek Produktiviteti në Punë”](#)
- » [Mbledhje XXX – Matrica e Rekomandimeve](#)
- » [Mbledhje XXX – Minutat](#)

TETOR 2023

- » [Mbledhje XXXI - Axhenda](#)
- » [Mbledhje XXXI – Prezantim PPT](#)
- » [Mbledhje XXXI – Dokument Pune “Për Përmirësimin e Cilësisë së Shërbimeve Publike të Digjitalizuara ndaj Biznesit”](#)
- » [Mbledhje XXXI – Matrica e Rekomandimeve](#)
- » [Mbledhje XXXI – Minutat](#)

DHJETOR 2023


- » [Mbledhje XXXII - Axhenda](#)
- » [Mbledhje XXXI – Minutat](#)

PUBLIKIME

- » [Procedurat e licencimit për instalimin e burimeve të rinovueshme të energjisë dhe kthimi në kohë i investimit \(për vetëprodhuesit\)](#)
- » [Gjetjet e Anketës “Pasigurtë e Biznesit mbi Diversifikimin e Energjisë” \(2023\)](#)
- » [Gjetjet e Anketës “Paga Minimale dhe Produktiviteti” \(2023\)](#)
- » [Gjetjet e Anketës “Cilësia e Shërbimeve Publike Digjitale sipas Këndvështrimit të Biznesit” \(2023\)](#)
- » [Vështrim mbi Treguesit Makro-Ekonomik \(Janar-Dhjetor 2022\)](#)
- » [Vështrim mbi Treguesit Makro-Ekonomik \(Janar-Qershor 2023\)](#)
- » [Raport mbi Progresin e Rekomandimeve të KI \(Gusht 2023\)](#)
- » [Raporti mbi Aktivitetin e KI \(2022\)](#)
- » [Raport Monitorimi i Rekomandimeve të KI \(2022\)](#)



Klikoni mbi titullin e dokumentit për ta shkarkuar.



PLANET PËR TË ARDHMEN

Kl do të vazhdojë të luajë një rol kyç në nxitjen e dialogut midis qeverisë dhe sektorit privat për të rikthyer besimin e investitorëve në Shqipëri, për të foruar mjedisin e biznesit dhe për të adresuar sfidat afat-mesme dhe afat-gjata me të cilat përballen bizneset. Agjenda e KI për vitin 2024, e përcaktuar përmes votimit të anëtarëve, përqendrohet në katër tema kryesore:

- Adresimi i Sfidave të Sektorit Privat: Informaliteti, Produktiviteti dhe Inovacioni
- Përmirësimi i konkurrueshmërisë së produkteve jo-ushqimore në tregun shqiptar dhe aksesimi i tyre në tregun e BE-së – Sfidat dhe Mundësitë
- Lehtësimi i Aksesit në Financë për Bizneset— Reduktimi i barrës administrative dhe zgjerimi i opsioneve të financimit për NMVM-të duke siguruar

transparencë në programet nxitëse

- Konsultim Publik nëpërmjet KI të Projekt-akteve sipas Planit të Punës të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) (Plani i Rritjes së BE-së, Ligji i Unifikuar i Investimeve, Programi i Promovimit të Eksporteve)

Gjithashtu, KI do të mbledhet katër herë gjatë gjithë vitit për të vlerësuar progresin e agjendës dhe për të shkëmbyer mendime mbi klimën e biznesit në vend. Sekretariati do të vazhdojë të organizojë takime konsultimi, të avokojë përfaqësimin e sektorit privat në tryeza dhe grupe pune, të kryejë vërtetime me komunitetin e biznesit, të monitorojë zbatimin e rekomandimeve dhe të rrisë ndërgjegjësimin për aktivitetet dhe fushat e ndikimit të KI.

Numra të rëndësishëm

4 MBLEDHJE TË KI

31 REKOMANDIME TË MIRATUARA

24 REKOMANDIME ZBATUARA, **20** NË PROCES

10 DOKUMENTE ANALITIKE

+20 SHOQATA/DHOMA TË BIZNESIT TË ANGAZHURA NË AKTIVITETE TË KI

1,475 BIZNESE TË PËRFAQËSUARA NGA SHOQATAT/DHOMAT ANËTARE NË KI

3 ANKETA ME BIZNESIN

905 KOMPANI PJESËMARRËSE NË VROJTIME

155 PJESËMARRJA E BIZNESIT NË MBLEDHJE TË KI DHE MBLEDHJE TË TJERA TEKNIKE

4 MBLEDHJE NË NIVEL TEKNIK (fokus grupe)

1 MEMORANDUM MIRËKUPIMI (me INSTAT)

1,100 TË ABONUAR NË FAQEN E KI

1 RAPORT VJETOR MONITORIMI MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË KI

55 INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE JANË INFORMUAR ZYRTARISHT MBI REKOMANDIMET E KI

85% NIVELI I PJESËMARRJES SË ANËTARËVE NË MBLEDHJE TË KI

43% BURRA **57%** GRA PJESËMARRJA GJINORE NË AKTIVITET TË KI

4,013 NDJEKËS NË MEDIAT SOCIALE (+19.4% nga viti i kaluar)

Anëtarë të KI 2023

Anëtarë, Institucione Shtetërore

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit

Banka e Shqipërisë

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës

Anëtarë, Partner Zhvillimi

Banka Botërore

Delegacioni i BE-së në Shqipëri

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)

Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC)

Anëtarë të Biznesit me Mandat të Përhershëm

Dhoma e Industrisë dhe Tregtisë Tiranë

Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare (ADBC)

Anëtarë të Biznesit me Mandat 2-Vjeçar

Dhoma Ekonomike e Gruas (DHEG)

Dhoma Amerikane e Tregtisë (AmCham)

Dhoma Turke e Tregtisë dhe Industrisë (ATTSO)

Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë

Anëtarë të Tjerët të Biznesit

Fix Pro sh.p.k.

Lufra sh.p.k.

Hotel Mondial

Proeksport Albania (PEA)

Instituti i Ekspertëve të Autorizuar Kontabël (IEKA)

Këshilli Shqiptar i Agrobiznesit (KASH)

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)



Improving Transparency and Investment Climate

Sekretariati i Këshillit të Investimeve - Stafi

Puna e Këshillit të Investimeve mbështetet nga Sekretariati, një organ i pavarur me profesionistë të përzgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërsëdrejti me komunitetin e biznesit.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoresh e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomike
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula

Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

f Albania Investment Council ALInvestCouncil in Albania Investment Council



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).